



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI**

---

Numri i lëndës: 2021:261639

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05504617

E.nr.174/2009

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Vushtri – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtarin Naim Rekaliu, në çështjen juridike përmbartimore të të kreditorit K. me seli në Prishtinë kundër debitorit B.P Komuna e Vushtrrisë, lidhur me propozimin për ekzekutim të borxhit, jashtë seancës me datë 26.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. KONSIDEROHET i tërhequr propozimi me numër E.nr.174/2009, i kreditorit K. me seli në Prishtinë, kundër debitorit B.P. Komuna e Vushtrrisë, lidhur me propozimin për ekzekutim të borxhit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës.

**A r s y e t i m**

Kreditori K. me datë 26.02.2009, pranë kësaj gjykate ka paraqitur propozim për ekzekutimin e borxhit.

Gjykata me konkluzionin E.nr.174/2009 i datës 16.02.2024 e ka obliguar kreditorin që në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimi të këtij konkluzioni të bëjë plotësimin e propozimit për përmbartim, gjegjësisht të precizojë shumën dhe periudhën për të cilën kërkohet borxhi ndaj debitorit dhe gjykatës t'ia dërgoj ekstraktin e verifikuar nga librat afaristë, në original apo kopje

të vërtetuar, konkluzion të cilin kreditori e ka pranuar me datë 23.02.2024, mirëpo i njëjti nuk e ka plotësuar propozimin brenda afatit të caktuar në konkluzion.

Meqenëse kreditori nuk e ka bërë plotësimin e propozimit dhe precizimin e kredisë për debitorin B,P brenda afatit të paraparë, gjykata vendosi që propozimin e tij të paraqitur pranë kësaj gjykate ta konsideroj të tërhequr.

Andaj, bazuar në të lartcekurat e konform nenit 102 par. 3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

E.nr.174/2009, datë 26.03.2024

Gj y q t a r i  
Naim Rekaliu

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.